



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:258302

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05298734

**2023:265620**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit A.K nga fsh....-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhje e sherbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 par.1 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.1675/23 të datës 2601.12.2023 , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.31.01.2024 në prezencë të Prokurorit të shtetit Mimoza Syla Hyseni, përfaqësuesit të dëmtuarës dhe të pandehurit, me dt.02.02.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.07.02.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri A.K nga fsh....- Kacanik, i lindur më dt...., nga i ati F... dhe e ema F..., e gjinisë G... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves , i martuar, prind i 2 femijeve, ka të kryer shkollën e mesme, i punesuar ne KRM- ..., i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:....

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse prej datës 12.01.2023 e deri me dt.12.08..2023, në fsh. Kaçanik i Vjetër Komuna Kacanik, saktësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri në vazhdimësi në njehsorin elektrik DFE:..., siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit, në atë mënyrë që gjatë kontrolleve nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS-it, Distrikti Ferizaj, është hasur duke e keqpërdorur energjinë elektrike, duke bërë lidhje direkte jashtë pikës matëse, të cilat janë evidentuar në bazë të procesverbalit me nr. 2060013 të dt.12.01.2023, 2175555 të dt.14.03.2023, 2061251 të dt.03.05.2023 dhe procesverbalit me nr.2064652 të dt. 12.08.2023, ku në të gjitha këto raste, njësori elektrik ka qenë i shkyqur nga distanca, derisa i pandehuri është lidhur direkt në rrjet pa matje, me të cilin rast energjia elektrike nuk është regjistruar fare, derisa dëmi i shkaktuar të dëmtuarës është 232.09 €.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale në vazhdim , Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,45,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, I cili dënim konfor nenit 45 par.1 të KPRK-së, i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej 200 orëve.

I pandehuri është i obliguar që punën në dobi të përgjithshme t'a kryejë në periudhen kohore në kohezgjatje prej 1 viti nga dita e plotfuqishmerise së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata do të urdhëroje dënimin me burgim duke llogaritur një ditë burgimi për çdo 8 (tetë) orë pune që nuk është kryer.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 30.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimin shumën prej 20.00€, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri, që të dëmtuarës, KEDS-Distrikti ne Ferizaj, t'i kompenzojë dëmin në shumë prej 232.09 €.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1675/23 të datës 01.12.2023, të pandehurin A.K nga fsh... -Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale Vjedhja e shërbimeve ne vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 par.1 te KPRK-se , dhe ka kërkuar qe I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.31.01.2024 me të cilin rast, prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës me autorizim, Trendelina Kryeziu, në fjalën e saj në pyetjen e gjyqtares deklaroi se, i bashkëngjitet ndjekjes penale të prokurorisë dhe parashtron kërkesën pasurore juridike në vlerën si në aktakuzë.

I pandehuri ne fjalën e tij ne pyetjen e gjyqtares e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, dhe shton se, në pamundësi për t'a paguar borgjin ndaj KEDS-it, meqë jeton në kushte të dobëta ekonomike, ka bërë lidhje ilegale në rrjetin elektrik, por që I premtonte gjykatës se do të bëjë përpjekje të vazhdueshme që të evitojë gjendjen kundërligjore që I përseritet ne vazhdimësi , prandaj edhe kërkon nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më I ulët që të jetë e mundur, duke patur parasysh të lartëcekurat si rrethana lehtësuese.

Prokurorja e shtetit ne fjalën e saj, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve ne vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 par.1 te KPRK-së, pasi që nje pranim i tillë u bë vullnetarisht nga ana e të pandehurit si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 242 të KPP-së, andaj i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbeshetet ne faktet e çeshtjes qe permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike, prandaj edhe pranoi pranimin e fajësië për të pandehurin.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimeve ne vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 par.1 te KPRK-se.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, duke shprehur keqardhje për veprimin e tij, dhe duke premtuar para gjykatës se në të ardhmen do të bëjë përpjekje të vazhdueshme që të evitojë gjendjen kundërligjore që I përseritet ne vazhdimësi, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti se, bazuar në evidencën e kësaj gjykate, raporti I së cilë I është bashkangjitur shkresave të lëndës, I njejtë evidentohet edhe për raste të tjera penale, për të cilat është gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm, kryesisht të kësaj natyre, si dhe shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit për të kryer veprën penale, meqë I njejtë pavarësisht se edhe në të kaluarën ka premtuar se do të bëjë përpjekje për të evituara gjendjen kundërligjore, I njejtë prapë e ka përsëritur veprimin e njejtë me arsyetimin e borgjit të akumuluar dhe pamundësisë për t'a paguar borgjin, ndërsa rrethanë tjetër të posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përveq veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën shpallur fajtor,

Andaj gjykata, për këto arsye të pandehurin A.K, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve ne vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 par.1 te KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe të mos kryejnë vepra te tilla penale duke ngritur vetëdijësimin per respektimin e ligjit dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEGA KAÇANIK**

**2023: 265620 datë 07.02.2024**

Sekretarja Juridike,  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.